



Shablloni i njoftimit të të drejtave të qiramarrësit për Strehim mbështetës

Ky njoftim ofron informacion të përgjithshëm rreth të drejtave të qiramarrësve për strehim mbështetës. Ofruesit e strehimit mbështetës duhet t'ua ofrojnë këtë njoftim qiramarrësve të ardhshëm dhe atyre të përhershëm.

- Në momentin e intervistës
- Në momentin kur qiramarrësi fillon të banojë aty
- Sa herë që rinovohet kontrata e qirasë ose marrëveshja e programit.
- Sipas kërkesës

Ofruesit e strehimit mbështetës duhet t'ua lexojnë këtë njoftim qiramarrësve që kanë vështirësi në të lexuarit dhe ta ofrojnë atë në njërën nga gjuhët e renditura më poshtë, nëse ofrohet në gjuhën tyre të preferuar të leximit. Ofruesit e strehimit mbështetës duhet t'i ndihmojnë qiramarrësit për ta përkthyer këtë njoftim nëse ai nuk është i përkthyer në gjuhën e tyre të preferuar. Ky njoftim disponohet në gjuhët e mëposhtme: Spanjolle, kineze, ruse, bengale, kreole haitiane, koreane, italiane, arabe, urdu, frënge dhe polake. Për të lexuar këtë njoftim në këto gjuhë, vizitoni nyc.gov/health dhe kërkonte [supportive housing](#) (Strehim mbështetës).

Të drejtat e qiramarrësit

Ky njoftim është një përmbledhje e përgjithshme e të drejtave tuaja si qiramarrës i strehimit mbështetës dhe nuk përfshin këshilla ligjore. Ai nuk themelon të drejta të reja që nuk ofrohen nga ligji. Rekomandohet fort që individët të mbajnë të dhëna të detajuara me shkrim për çdo çështje që ka të bëjë me strehimin. Nëse keni nevojë për më shumë informacion specifik, telefononi **311** dhe kërkonte të lidheni me "Tenant Help Line" (Linja telefonike e ndihmës për qiramarrësit).

Si qiramarrës i strehimit mbështetës, ju:

1. Keni të drejtën të jetoni pa rrezikuar shëndetin, si për shembull, nga insektet ose brejtësit, rrjedhjet, myku ose sendet e dëmtuara. Keni të drejtën për shërbime publike si ngrohja, uji i ngrohtë, energjia elektrike dhe gazi.
 - a. Për të bërë një kërkesë për mirëmbajtje, telefononi ekipin e mirëmbajtjes së ndërtesës tuaj ose ofruesin e strehimit mbështetës, duke përdorur të dhënat e kontaktit më poshtë në "Informacion rreth ndërtesës".
 - b. Telefononi **311** për të raportuar çdo çështje të vazhdueshme që nuk është zgjidhur dhe që inspektimi të kryhet nga Departamenti i Ruajtjes dhe Zhvillimit të Strehimit të Nju Jorkut (NYC Department of Housing Preservation and Development, HPD) për banesën tuaj.
 - c. Pronari i objektit ose ofruesi i strehimit duhet t'ju ofrojë një kopje të procedurave të ankesave të tyre gjatë regjistrimit, rinovimit të kontratës së qirasë dhe kur bëhen përditësime, në mënyrë që të dini si të reagoni ndaj çdo problemi lidhur me njësinë tuaj.

2. Ngrini një çështje gjyqësore kundër pronarit, menaxherit të pronës ose ofruesit të strehimit mbështetës për të korrigjuar shkeljet e Kodit të Mirëmbajtjes së Strehimit të Qytetit të Nju Jorkut (NYC's Housing Maintenance Code), përfshirë ngacmimin. Për më shumë informacion, telefononi **311** dhe kërkoni të lidheni me "Tenant Help Line" (Linja telefonike e ndihmës për qiramarrësit) ose paraqituni pranë Gjykatës së Çështjeve të Strehimit të njësisë suaj administrative.
 - a. Nëse pronari i pronës ju ka lënë jashtë ose po përpiqet t'ju detyrojë të largoheni nga banesa juaj, telefononi menjëherë **911** për të raportuar një pengim të paligjshëm. Më pas telefononi **311** dhe kërkoni të lidheni me "Tenant Help Line" (Linja telefonike të ndihmës për qiramarrësit)
3. Një proces gjyqësor përpara se të dëboheni
 - a. Ju mund të përfitoni nga **shërbimet ligjore falas për mbrojtje nga dëbimi**, pavarësisht kodit tuaj postar të banimit ose statusin tuaj të imigracionit, sipas ligjit "Për të drejtën për avokat" (Right-to-Counsel) në qytetin e Nju Jorkut. Për t'u lidhur me një avokat falas, mund të:
 - i. Telefononi **311** dhe kërkoni të lidheni me "Tenant Help Line" (Linja telefonike e ndihmës për qiramarrësit)
 - ii. Telefononi linjën telefonike për përgjigjet nga Gjykata e Çështjeve të Strehimit (Housing Court Answers Hotline) në 718- 557-1379.
 - iii. Kërkoni shërbime ligjore falas që nga paraqitja juaj e parë në gjykatë.
 - b. **Askush nuk mund t'ju dëbojë pa një urdhër gjykatë.** Ju gjithashtu duhet të merrni një njoftim nga Marshalli i qytetit (City Marshall) ose Zyra e Sherifit të Qytetit (Office of the City Sheriff) përpara se të mund të dëboheni ligjërisht.
 - c. Personi ose subjekti që po përpiqet t'ju dëbojë duhet të dorëzojë një kërkesë që përmban informacione të caktuara të përshkruar në ligin "Për veprimet dhe procedurat gjyqësore për pronat e paluajtshme", neni 741 (Real Property Actions and Proceedings Law, Section 741). Për më shumë informacion rreth kësaj kërkesë, ju mund të:
 - i. Telefononi **311** dhe kërkoni të lidheni me "Tenant Help Line" (Linja telefonike e ndihmës për qiramarrësit)
 - ii. Telefononi linjën telefonike për përgjigjet nga Gjykata e Çështjeve të Strehimit në 718- 557-1379.
4. Kërkoni ndryshime të arsyeshme në banesën tuaj, shërbime ose të dyja sipas përshtatjes së një aftësie të kufizuar fizike, të shëndetit mendor, ose psikologjik dhe për t'u mbrojtur nga çdo diskriminim në banesën tuaj.
 - a. Për të kërkuar një përshtatje të arsyeshme për një aftësi të kufizuar, kontaktoni me ofruesin tuaj të strehimit mbështetës, duke përdorur të dhënat e kontaktit më poshtë.
 - b. Nëse besoni se të drejtat tuaja janë shkelur, telefononi Komisionin e Qytetit të Nju Jorkut për të Drejtat e Njeriut (NYC Commission on Human Rights) në nr. 212-416-0197.
5. Merrni faturat e qirasë dhe kërkoni një regjistër financiar të pagesave dhe qirasë së papaguar, si dhe kopje të ricertifikimeve vjetore të të ardhurave, kontratave dhe

marrëveshjeve të qirasë. Për të kërkuar këtë informacion, kontaktoni me ofruesin tuaj të strehimit mbështetës, duke përdorur të dhënat e kontaktit më poshtë.

6. Banimi me familjen, me të afërm me lidhje familjare dhe në disa rrethana banimi me shok/shoqe dhome. Njoftoni ofruesin tuaj të shërbimeve sociale nëse dëshironi të shtoni të tjerë në familjen tuaj (të mitur ose të rritur, bashkëshort/e, ose partner/e). Ofruesi juaj do të diskutojë ndërlikimet kur shtoni pjesëtarë të tjerë të familjes, duke përfshirë vendimin nëse strehimi është i përshtatshëm ose nëse ligjërisht e lejueshme për banorë të tjerë; çdo kufizim të mundshëm të të ardhurave për strehimin juaj, siç janë ato të imponuara në ndërtesat me Lehtësim të Taksës për Banesat me të Ardhura të Ulëta (Low-Income Housing Tax Credit, LIHTC); dhe se si mund të ndryshojë llogaritja e qirasë dhe kontrata ose nënkontrata e qirasë.

7. Bashkimi ose krijimi i një grupi, si një shoqëri qiramarrësish, për të mbështetur të drejtat dhe në mbrojtje të qiramarrësve pa ngacmime, hakmarrje ose ndëshkime. Ju mund të zhvilloni këto mbledhje në hapësirat e përbashkëta të ndërtesës tuaj pa pasur nevojë të paguani një tarifë për përdorimin e saj. Ju duhet të njoftoni paraprakisht ofruesin e strehimit mbështetës.

Informacioni në vijim do të plotësohet nga ofruesi i strehimit mbështetës.

Të dhënat e ofruesit të strehimit mbështetës		
Emri i ofruesit të strehimit mbështetës:	Nr. i telefonit:	Emaili:
<p>Agjencia që mban kontratën për ofruesin e strehimit mbështetës të mësipërm (shënoni të gjitha që vlejnë):</p> <p><input type="checkbox"/> Departamenti i Shërbimeve Sociale të Qytetit (Department of Social Services) të Nju Jorkut/Administrata e Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration)</p> <p><input type="checkbox"/> Departamenti i Ruajtjes dhe Zhvillimit të Strehimit të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Housing Preservation and Development) <input type="checkbox"/> Departamenti i Shëndetit Fizik dhe Mendor i Qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Health and Mental Hygiene) Për të paraqitur një ankesë pranë kësaj agjencie, telefononi në 311.</p> <p><input type="checkbox"/> Tjetër: _____</p> <p>Për të paraqitur një kërkesë, kontaktoni me:</p>		
Shërbime e disponueshme mbështetëse:		
Kontaktoni për të marrë një kopje të politikave dhe procedurave gjyqësore për të kërkuar ose ndryshuar shërbimet:	Nr. i telefonit:	Emaili:

Për të kërkuar një kopje të burimeve të financimit të ofruesit (përfshirë një listë të rregulloreve kryesore që zbatohen për të gjitha burimet e financimit); politikat për dëbim dhe ankesa (përfshirë procesin dhe afatin kohor për përgjigjen e ofruesit); ose informacion mbi ndihmën për pagesën e prapambetur të qirasë ose ndihmë për menaxhimin financiar, kontaktoni me:

Emri:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Emri:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Emri:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Për të diskutuar çështje që lidhen me shërbimet sociale ose menaxhimin e rasteve, kontaktoni me:		
Emri:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Emri:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Emri:	Nr. i telefonit:	Emaili:

Informacion rreth ndërtesës

Adresa (përfshirë numrin e njësisë, nëse ka):		
Pronari i pronës:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Menaxheri i pronës:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Për riparime ose mirëmbajtje, kontaktoni me:		
Emri:	Nr. i telefonit:	Emaili:
Informacione shtesë:		
Qiraja mujore totale:		

Pjesa e qirasë nga ofruesi:		
Pjesa e qirasë nga qiramarrësi:		
A është qiraja e njësisë e rregulluar me ligj?	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
	<input type="checkbox"/> Nuk dihet	
Për të kërkuar historikun e qirasë së një njësie, kontaktoni me Divizionin e Strehimit dhe Rivitalizimit të Komunitetit (Division of Housing and Community Renewal) të Shtetit të Nju Jorkut në: Ofruesi i mësipërm i strehimit mbështetës do t'ju ofrojë ndihmë që të keni historikun e qirasë së njësisë.	Nr. i telefonit:	Emaili:
A është kjo njësi në një ndërtesë që përfiton nga lehtësimi i taksave ose përjashtimi tatimor?	<input type="checkbox"/> Po Data e fillimit: Data e përfundimit:	<input type="checkbox"/> Jo
A është kjo njësi e subvencionuar nga një subvencion për familjen?	<input type="checkbox"/> Po Komunikoni për të mësuar më shumë rreth procesit për të kërkuar një transferim:	<input type="checkbox"/> Jo

Duke nënshkruar më poshtë, ju e pranoni që keni marrë një kopje të këtij njoftimi nga ofruesi i strehimit mbështetës për një apartament që keni vizituar me qëllim për të banuar aty ose për një apartament ku jetoni.

Emri i qiramarrësit ose i qiramarrësit të ardhshëm:	
Nënshkrimi:	
Data:	

Ofruesi i strehimit mbështetës duhet t'u japë një kopje qiramarrësve të ardhshëm dhe atyre të përhershëm.

Një kopje e nënshkruar do të vendoset në dosjen e personit pranë ofruesit të strehimit mbështetës.